

Deklarata e privatësisë së punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm e Paypal-it

Data e hyrjes në fuqi: 1 janar 2026

Përmbajtja

I.	Përmbledhja	2
II.	Të dhënat personale që mbledhim.....	2
III.	Pse mbledhim të dhëna personale.....	6
IV.	Përse i ndajmë të dhënat personale	14
V.	Si dhe ku i transferojmë dhe ruajmë të dhënat tuaja personale	15
VI.	Si e mbrojmë informacionin tuaj?	15
VII.	Sa kohë i mbajmë të dhënat tuaja personale?	16
VIII.	Të drejtat tuaja të privatësisë	16
IX.	Ndryshimet në këtë deklaratë	17
X.	Gjuha	17
XI.	Na kontaktoni	17

I. Përmbledhja

Kjo Deklaratë e Privatësisë shpjegon si dhe pse PayPal, Inc. dhe secili nga filialet apo degët e tij ("PayPal", "ne", "neve" dhe "e jona"), duke përfshirë subjektin PayPal për të cilin punoni (secili "Subjekt PayPal") mbledh, ruan, përdor, transferon dhe ndan të dhënat personale rreth jush gjatë dhe pas marrëdhënies suaj të punës me ne, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Kjo Deklaratë e Privatësisë zbatohet për të gjithë punonjësit e PayPal-it dhe individët që janë bashkëpunëtorë të jashtëm. Kjo Deklaratë e Privatësisë nuk është pjesë e asnjë kontrate pune apo kontrate tjetër për të ofruar shërbime.

Kontrolluesi përgjegjës i të dhënave për të dhënat tuaja personale është subjekti PayPal për të cilin punoni. Për shembull, nëse punoni në një pozicion të PayPal në Australi, subjekti PayPal është PayPal Australia Pty, Ltd. Nëse punoni në një pozicion të PayPal në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti PayPal është PayPal UK Ltd., nëse punoni në një pozicion të PayPal në SHBA, subjekti PayPal është PayPal, Inc. ose PayPal Data Services, Inc. nëse punoni për në pozicion të PayPal në Kanada, subjekti PayPal është PayPal Canada Co.

Asgjë në këtë Deklaratë Privatësie nuk ka për qëllim të reduktojë ose të heqë ndonjë të drejtë apo mbrojtje që mund të keni sipas ligjit në fuqi, në vendin apo juridiksionin tuaj. Në rast se diçka në këtë Deklaratë Privatësie nuk përputhet me ndonjë ligj të tillë, do të mbizotërojë e drejta dhe/ose mbrojtja përkatëse. Kjo do të thotë se disa nga aktivitetet e përpunimit të përshkruara mund të mos kryhen në disa shtete. Na kontaktoni nëse dëshironi informacione të mëtejshme në lidhje me këtë ose, referojuni njoftimit ose dokumentit shtesë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në juridiksionin tuaj, nëse ju ofrohet.

II. Të dhënat personale që mbledhim

Ne mbledhim për punonjësit të dhënat personale që ju jepni gjatë procesit të aplikimit dhe gjatë periudhës së punësimit. Gjithashtu, në masën e nevojshme për qëllimet e përcaktuara në seksionin III më poshtë dhe në përputhje me ligjin në fuqi, ne mund të mbledhim informacion rreth jush nga burime të tjera ose palë të treta, si LinkedIn, faqet e tjera të mediave sociale, agjencitë e rekrutimit, agjencitë e referencës së kreditit ose agjencitë e tjera të kontrollit të figurës apo kompanitë në të cilat keni punuar para se të punësoheshit në PayPal. Kjo përfshin informacione për ju gjatë kohës që keni punuar për një kompani të blerë nga PayPal.

Për bashkëpunëtorët e jashtëm, ne mund të mbledhim të dhëna personale të ofruara nga kompania juaj si pjesë e procesit, për t'ju siguruar punë në PayPal ose gjithashtu mund të mbledhim drejtpërdrejtë të dhëna personale rreth jush. Nëse pranoni punë ose një angazhim në PayPal, ne do të mbledhim të dhënat personale që jepni gjatë periudhës së punës në PayPal të rënë darkord.

Ne mbështetemi në baza të ligjshme të caktuara për të mbledhur, përdorur dhe përpunuar të dhënat tuaja personale, të cilat ndryshojnë sipas përdorimit të veçantë të të dhënave personale. Këto mund të përfshijnë sa më poshtë (gjithmonë në masën e lejuar nga ligjet në fuqi):

- zbatimin e një kontrate dhe domosdoshmërinë e përpunimit para se të lidhim një kontratë me ju ("Kontrata");
- për qëllimet dhe interesat tona legjitime (me kusht që interesat dhe të drejtat tuaja themelore të mos i shkelin këto qëllime) ("Interesat legjitime");

- kur kërkohet me ligj ose në një formë tjetër që të respektojmë të drejtat dhe detyrimet tona ligjore ose të ushtrojmë të drejta në lidhje me punësimin ose angazhimin tuaj ("Kërkesat ligjore");
- me pëlqimin tuaj, ku na keni dhënë deklaratën tuaj të pëlqimit ("Pëlqimi");
- kur është e nevojshme në interes të publikut, si për shembull për monitorimin e mundësive të barabarta ("Interesi publik");
- kur është e nevojshme në mënyrë që të mbrohen interesat tuaja themelore ose të dikujt tjetër ("Interesat themelore"); ose
- kur është e zbatueshme, në përputhje me shkaqe të tjera ligjore të parashikuara nga ligjet ose rregulloret e zbatueshme.

Ne japim më shumë kontekst se kur mbështetemi në secilën prej këtyre shkaqeve në tabelën e seksionit III më poshtë.

Detyrimet tona dhe lloji i të dhënave personale që mbledhim dhe përpunojmë mund të ndryshojnë në varësi të rajonit tuaj. Është e rëndësishme të theksohet se nëse nuk i jepni PayPal-it të dhënat personale në rrethanat e theksuara në Deklaratën e Privatësisë, mund të rezultojë në mosrespektim të detyrimeve ligjore nga ana juaj ose e PayPal-it ose mund të konstatohet se është në shkelje me ligjet e zbatueshme, rregullat, rregulloret ose urdhërat e gjykatave ose autoriteteve kompetente.

Kur kërkohet, ne mund t'ju kontaktojmë për pëlqimin tuaj me shkrim për të na lejuar të përpunojmë disa të dhëna personale (duke përfshirë kategori të veçanta të të dhënave personale, të përcaktuara si të dhëna delikate në disa rajone). Çdo pëlqim i tillë i nënshtrohet ligjeve të shtetit në të cilin ndodheni dhe për këtë arsye, pëlqimet mund të ndryshojnë për punonjësit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në fushëveprimin dhe pasojat e tyre. Kur ne kërkojmë pëlqimin tuaj, ne do të përpiqemi të sigurojmë që pëlqimi juaj të jetë specifik, i informuar, pa mëdyshje, me vullnet të lirë dhe të plotë e i dhënë lirisht dhe se, duke iu nënshtuar ligjeve të zbatueshme, ju nuk vuani asnjë pasojë të padëshiruar nga një vendim për anulimin e pëlqimit ose nëse zgjidhni të mos e jepni atë. Rekomandojmë të lexoni në detaje çdo pëlqim që kërkojmë nga ju për t'u siguruar që e kuptoni plotësisht qëllimin e pëlqimit dhe cilat mund të jenë pasojat nga dhënia, ose jo e një pëlqimi të tillë.

Nëse na jepni pëlqimin tuaj, çdo e dhënë personale e ofruar sipas këtij pëlqimi do të mund të aksesohet vetëm nga ata që duhet ta dinë. Mund ta anuloni këtë pëlqim në çdo kohë. Kini parasysh që, sidoqoftë, kjo nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të kryer para tërheqjes së pëlqimit tuaj.

Kategoritë e të dhënave personale që mund të mbledhim rreth jush, në varësi të rajonit ku jeni të punësuar:

1. Informacionin që ju identifikon ju ose personat në varësinë tuaj, përfituesit dhe individët e tjerë të lidhur me punësimin tuaj, për shembull:
 - Emrin, duke përfshirë emrin e preferuar
 - Informacionin e kontaktit (si p.sh. adresa, numri i telefonit dhe adresa e email-it), duke përfshirë informacionin e kontaktit të në rast emergjence
 - Numri i pasaportës dhe detajet në lidhje me të
 - Numrin e sigurimeve shoqërore (SSN), ID-në kombëtare, ID-në tatimore ose numrin/identifikuesin ekuivalent

2. Të dhënat dhe informacioni financiar të mbledhura nga ju dhe/ose një palë e tretë, për shembull:
 - Historiku i punësimit, regjistrimet dhe informacionet e performancës
 - Vendndodhja e vendit të punës, paga, pushimet vjetore dhe informacioni i përfitimeve
 - Arsimi dhe kualifikimet profesionale
 - Informacioni i kontrollit të figurës (duke përfshirë kontrollet e kreditit, shqyrtimin e OFAC-it dhe informacionet penale dhe të lidhura me figurën)
 - Informacioni tatimor lidhur me punësimin ose angazhimin tuaj
 - Informacioni për pagesën
 - Informacioni për llogarinë në PayPal, kartën e kreditit dhe debitit
 - Informacioni i rekrutimit (përfshirë të drejtën për dokumentacionin e punës, referencat dhe informacione të tjera të përfshira në një CV ose letër motivimi si pjesë e procesit të aplikimit)
 - Data dhe arsyeja e largimit
 - Rezultatet e kontrolleve të statusit të punësimit, të dhënat e interesit tuaj dhe lidhja me ndërmjetësin nëpërmjet të cilit ofrohen shërbimet tuaja
 - Anëtarësimi në këshillin e punësimit/tregtisë/punës
3. Karakteristikat personale, kur lejohet sipas ligjit në fuqi në juridiksionin tuaj (p.sh. në disa shtete "binari gjinor" nuk njihet ligjërisht dhe për këtë arsye ne nuk do të mbledhim të dhëna rreth identitetit tuaj gjinor), për shembull:
 - Moshën
 - Gjininë
 - Identitetin gjinor
 - Origjinën kombëtare
 - Informacionin për aftësi të kufizuara
 - Statusin e kujdestarit
 - Statusin martesor
 - Statusin prindëror dhe të shtatzënisë
 - Statusin e ushtarakut dhe/ose të veteranit
 - Të dhënat shëndetësore, duke përfshirë çdo gjendje mjekësore, të dhënat shëndetësore dhe të sëmundjeve, informacionet e lidhura me vaksinimet kundër sëmundjeve të transmetueshme ose imunitetin nga këto
 - Shtetësinë
 - Statusin LGBTQ+
 - Racën
 - Etnicitetin
 - Karakteristikat ose përshkrimin fizike
4. Aktivitetet në internet ose aktivitete të tjera në rrjete elektronike, për shembull:
 - Ndërveprimet me faqet tona të internetit, aplikacionet, pajisjet ose pronat e tjera digjitale, email-et e dërguara dhe të marra
 - Të dhënat e vendndodhjes gjeografike
 - Informacioni i mediave sociale
5. Informacioni me audio, zë, elektronik, vizual ose i ngjashëm, për shembull:
 - Fotografi dhe video
 - Regjistrimet e thirrjeve (takime/shërbim ndaj klientit)
6. Informacioni që ne nxjerrim në bazë të të dhënave tuaja personale, për shembull:

- Vlerësimet e mashtimit dhe të rrezikut
- Përshtatja për rolet dhe potenciali i zhvillimit

Deklarata e CCPA

Nëse jeni banor i Kalifornisë, për qëllime të Aktit të Privatësisë së Konsumatorit në Kaliforni siç është ndryshuar dhe ofruar vetëm nga Ligji për të Drejtat e Privatësisë në Kaliforni (CCPA), shikoni më poshtë një përmbledhje të kategorive të të dhënave personale të mbledhura rreth jush, sipas rastit, dhe se si kategori të tilla deklarohen në CCPA:

Kategoritë e të dhënave personale	Shembuj
Identifikuesit	Emri, adresa IP, identifikuesit personalë unik, numri i sigurimeve shoqërore, emrat e përdoruesit
Kategoritë e të dhënave personale sioas Kodit Civil të Kalifornisë 1798.80(e)	Emri, adresa, numri i sigurimeve shoqërore, numri i telefonit, historiku i punësimit, numri i pasaportës, karakteristikat ose përshkrimi fizik
Karakteristikat e klasifikimeve të mbrojtura sipas ligjit kalifornian ose atij federal	Gjinia, statusi martesor, raca, paaftësia fizike, gjendja mjekësore, seksi, moshë
Informacion personal i ndjeshëm	Numri i sigurimeve shoqërore, numri i pasaportës, informacioni personal i llogarisë në PayPal dhe Venmo duke përfshirë postën, email-in dhe mesazhet me tekst lidhur me këto llogari, racën, informacionin shëndetësor, informacionin e orientimit seksual, informacionin biometrik
Informacione tregtare, duke përfshirë të dhënat e pasurisë personale, produkteve apo shërbimeve të blera, të përfutuara ose të konsideruara, ose historikun e konsumit ose tendencat.	Vetëm në masën e mbledhur si pjesë e "Internetit apo informacioneve të tjera të aktivitetit të rrjetit elektronik"
Informacioni i aktivitetit në internet ose në rrjete të tjera elektronike	Ndërveprimet me faqet tona të internetit, aplikacionet, pajisjet ose pronat e tjera digjitale
Të dhënat e vendndodhjes gjeografike	Vendndodhja e saktë e një pajisjeje
Informacione audio, elektronike, vizuale, termike, të nuhatjes ose të ngjashme	Shikoni "Informacioni i aktivitetit në internet ose në rrjete të tjera elektronike"
Informacionet profesionale ose që kanë të bëjnë me punësimin	Rezymeja, CV, testet e aftësive, historiku i punësimit, referencat, kualifikimet dhe certifikatat profesionale, aftësitë
Informacione mbi arsimin	Historiku i arsimit, diplomat e marra, datat aktuale apo të parashikuara të diplomimit

Konkluzionet e nxjerra nga kategoritë e të dhënave personale më sipër	Aftësitë, interesat, produktiviteti
---	-------------------------------------

III. Pse mbledhim të dhëna personale

Ne mbledhim informacionin tuaj sipas nevojës për qëllimet e punësimit ose angazhimit tuaj në PayPal. Konkretisht, ne mbledhim, përdorim dhe përpunojmë të dhënat personale si për punonjësit ashtu edhe për bashkëpunëtorët e jashtëm për qëllimet e përshkruara më poshtë sipas bazës së ligjshme të listuar, e cila mund të ndryshojë në varësi të ligjit dhe juridiksionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

Qëllimi	Shkak ligjor	Interesi legjitim (nëse ka)
Kontrollet e verifikimit para punësimit dhe angazhimit (duke përfshirë edhe kontrollin nëse keni të drejtë ligjore për të punuar në qarkun në të cilin punoni)	Kontrata Kërkesa ligjore Mjekësia profesionale ose parandaluese për vlerësimin e aftësisë së punëmarrësit për të punuar	
Menaxhimi i angazhimit ose punësimit tënd të përgjithshëm me ne dhe administrimi i kontratës që kemi lidhur me ju (ose një kompani të tretë, nëse është e zbatueshme në rastin e bashkëpunëtorve të jashtëm)	Kontrata Kërkesa ligjore Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	
Për të menaxhuar dhe lehtësuar mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit në lidhje me rolin tuaj ose siç kërkohet nga ligji, dhe për të zhvilluar aftësi të reja si pjesë e zhvillimit të përgjithshëm të karrierës suaj	Kërkesa ligjore Interesa legjitime	Është në interesin tonë të menaxhojmë punësimin tënd dhe të mbështesim zhvillimin tënd të përgjithshëm të karrierës
Zgjidhja e çështjeve disiplinore ose të lidhura me ankesën	Kontrata Kërkesa ligjore Ushtrimi i interesit legjitim të të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona të sigurohemi që ju respektoni të gjitha politikat dhe procedurat
Menaxhimi i lejeve ose mungesave tuaja nga puna	Kontrata Ushtrimi i interesave legjitime të të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesin tonë që të sigurojmë dhe rregullojmë kompensimin në përputhje me rrethanat, si dhe për të siguruar mbulimin e duhur gjatë mungesës suaj
Menaxhimi i aksesit në objektet, pajisjet dhe sistemet e PayPal	Kontrata Ushtrimi i interesave legjitime të të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona t'ju sigurojmë objekte, pajisje dhe sisteme që janë të përshtatshme për nevojat tona të biznesit dhe t'ju lejojmë të përmbushni rolin tuaj në PayPal

Për të garantuar sigurinë dhe ruajtjen e aseteteve, pronave, objekteve, informacionin e klientit dhe personelit të PayPal-it për t'ju mbajtur të sigurt dhe për të siguruar një mjedis të sigurt pune	Kërkesa ligjore Ushtrimi i interesave legjitime të të drejtave ligjore të përcaktuara në punësim e punësimit	Është në interesat tona të garantojmë që ju dhe pasuritë, pronat, objektet dhe informacionet tona, të mbroheni dhe të mbaheni të sigurt
---	---	---

Menaxhimi, vlerësimi dhe marrja e vendimit në lidhje me detyrat dhe performancën tuaj të punës	Kontrata Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit Pëlqimi	Është në interesat tona të sigurohemi që jeni duke kryer detyrat tuaja në përputhje me rolin e rënë dakord dhe t'ju vlerësojmë performancën për tu siguruar që jeni të kënaqur me rolin tuaj dhe që po arrini qëllimet e rolit tuaj
Menaxhimi i udhëtimeve të punës dhe rimbursimi i shpenzimeve në përputhje me politikat e T&E dhe programet e zhvendosjes së punës	Kontrata Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona të sigurohemi që ju rimbursoheni në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme për çdo shpenzim të kryer në përputhje me politikat dhe procedurat
Mundësimi t'ju kontaktojmë ju (ose anëtarët e familjes suaj) në raste emergjence	Interesat jetike Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona të sigurojmë që ju ose anëtarët e familjes suaj të kontaktoheni në rast të ndonjë urgjence të mundshme ose konkrete
Kryerja e hetimeve të brendshme (për shkelje të mundshme të ligjit dhe politikave të PayPal ose parandalimi i mashtrimeve)	Kërkesat ligjore Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona të hetojmë shkeljet e mundshme ose faktike të ligjeve apo politikave të PayPal-it ose të parandalojmë mashtrimin, pasi duhet të garantojmë një mjedis të ligjshëm dhe të sigurt dhe mund të mbajmë përgjegjësi për veprimet e gabuara të personelit tonë
Për të respektuar detyrimet tona ligjore, për shembull kontrollet e sanksioneve (p.sh. Zyrën e Kontrollit të Pasurive të Huaja (OFAC)), si dhe përmbushjen e	Kërkesat ligjore Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	

dokumentacionit në lidhje me tatimet, kontabilitetin, sigurimet shoqërore, rregullatoret dhe sigurimet, lidhur me dorëzimin, auditimet dhe detyrimet e orarit të punës		
--	--	--

Përcaktimi, ushtrimi dhe mbrojtja e pretendimeve ligjore	Kërkesat ligjore Interesa legjitime Inicioni ose mbroni pretendimet ose procedimet ligjore	Është në interesat tona të sigurohemi se jemi të përgatitur në mënyrë të duhur dhe të përshtatshme për të ngritur ose ushtruar ndonjë pretendim ligjor kundër jush ose të tjerëve, ose për të mbrojtur ndonjë pretendim nga ju ose nga të tjerët
Sipas kërkesave të ligjit në fuqi, për të monitoruar përdorimin nga ana juaj të sistemeve tona të informacionit dhe komunikimit për të garantuar respektimin e sigurisë sonë të informacionit, politikat dhe procedurat e privatësisë dhe politikat e tjera të kompanisë PayPal	Interesa legjitime Pëlqimi	Është në interesat tona të sigurojmë që sistemet tona të informacionit dhe komunikimit të përdoren në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme dhe të përshtatshme dhe në çdo kohë në përputhje me Sigurinë tonë të Informacionit, politikat e privatësisë dhe procedurat dhe politikat e tjera të kompanisë së PayPal-it

Informimi i blerësve potencialë dhe këshilltarëve të tyre profesionistë në lidhje me një shitje, shitje të një pjese të aseteve ose transferim të të gjithë ose një pjese të biznesit tonë	Interesa legjitime Pëlqimi	Është në interesin tonë t'u ofrojmë blerësve potencialë dhe këshilltarëve të tyre profesionistë të dhëna personale të kufizuara, të nevojshme për të pasqyruar strukturën dhe fuqinë punëtore të PayPal në lidhje me një shitje, shitje të një pjese të aseteve ose transferim të të gjithë ose një pjese të biznesit tonë
Garantimi i sigurisë së rrjetit dhe informacionit, duke përfshirë parandalimin e aksesit të paautorizuar në sistemet tona kompjuterike dhe elektronike të komunikimit dhe parandalimin e shpërndarjes së softuerëve keqdashës	Kërkesat ligjore Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit Pëlqimi	Është në interesat tona të mbrojmë sistemet, të dhënat (duke përfshirë të dhënat tuaja personale), informacionin dhe prona të tjera
Garantimi i shëndetit dhe sigurisë suaj në vendin e punës dhe vlerësimi i gjendjes në punë, për të siguruar akomodim të përshtatshëm në vendin e punës, monitorimi dhe menaxhimi i mungesës dhe administrimi i përfitimeve. Të gjitha të dhënat dhe informacionet mjekësore do të ruhen veçmas nga regjistri juaj i punonjësit	Kërkesa ligjore Interesa legjitime Interesa jetësore Mjekësia profesionale ose parandaluese për vlerësimin e aftësisë së punëmarrësit për të punuar Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në interesat tona t'ju garantojmë mjedisin më të përshtatshëm të punës dhe që të jeni në formën më të mirë për të punuar për të siguruar kryerjen dhe produktivitetin e punës
Menaxhimi i abonimeve për të përfituar planet e ofruara nga PayPal	Kontrata Interesa legjitime Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	Është në intereat tona t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale në mënyrë që të mund t'ju ofrohen me përfitimet që keni rënë dakord
Analiza e diversitetit dhe përfshirjes, nismat dhe njohuritë	Interesi publik Interesa legjitime Kërkesa ligjore Pëlqimi	Është në interesat tona t'i mbledhim të dhënat personale lidhur me diversitetin dhe përfshirjen për të garantuar që PayPal është duke iu përmbajtur parimeve të veta

		të diversitetit
Ofrimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta	Kërkesa ligjore	
Për të përpunuar kompensimet dhe shpërblimet dhe, nëse jeni punonjës ose i konsideruar punonjës për qëllime tatimore, për zbritjen e kontributeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore	Kontrata Kërkesa ligjore	
Ofrimi dhe menaxhimi i përfitimeve tuaja dhe të personave që varen nga ju të tilla si aksionet, sigurimet, programet financiare dhe të mirëqënies dhe përputhjen e donacioneve dhe përfitimeve të tjera të punonjësve, duke përfshirë pagesën ligjore të mëmësisë dhe pagesën ligjore për sëmundje	Kontrata Kërkesa ligjore Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	
Për t'ju regjistruar në një marrëveshje pensioni në përputhje me detyrat tona ligjore	Kontrata Kërkesa ligjore Ushtrimi i të drejtave ligjore të përcaktuara në fushën e punësimit	
Mbështetja e programeve vullnetare të sponsorizuara nga kompania dhe grupet e burimeve të punonjësve	Interesa legjitime Pëlqimi	Është në interesat tona të sigurohemi që ju të jeni në gjendje të merrni pjesë në programet vullnetare dhe grupet e burimeve duke lehtësuar këto programe dhe grupe
Identifikimi i mundësive reja në PayPal	Interesa legjitime Pëlqimi	Është në interesat tona të kërkojmë dhe të identifikojmë mundësi të reja biznesi
Kryerja e studimeve analitike të të dhënave për të shqyrtuar dhe kuptuar më mirë normat e mbajtjes dhe zvogëlimit të numrit të punonjësve	Interesa legjitime Pëlqimi	Është në interesat tona të kuptojmë normat e punonjësve dhe zvogëlimin e numrave të tyre për të siguruar që ne po veprojmë në mënyrë efektive si

		një forcë punëtore dhe biznes
Mundësimi i këshillit të punës të punojë brenda fushës së të drejtave të tij ligjore, kur ka	Kërkesa ligjore	

PayPal gjithashtu mund të përpunojë të dhënat personale të ofruara nga ju për anëtarët e familjes, personat që varen nga ju dhe të njohurit sipas kërkesës, për qëllimet e mëposhtme: për njoftim në situata emergjente, për planet e përfitimeve të dhëna nga PayPal dhe çdo plan tjetër fleksibël të kompensimit sipas nevojës. Duke pranuar këtë Deklaratë Privatësie, ju konfirmoni se i keni informuar ata njerëz dhe keni marrë të dhënat e tyre personale në përputhje me këtë dispozitë dhe ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Disa nga qëllimet e listuara në tabelën e mësipërme kërkojnë që ne të përpunojmë të dhënat tuaja personale delikate (të njohura edhe si "kategori e veçantë e të dhënave"). Ne do të përdorim të dhëna personale veçanërisht delikate në mënyrat e mëposhtme dhe për qëllimet e mëposhtme (gjithmonë në masën e lejuar ose siç kërkohej nga ligjet në fuqi):

- do të përdorim informacione në lidhje me shëndetin tuaj fizik, mendor ose statusin e invaliditetit, për të siguruar shëndetin dhe sigurinë tuaj, të stafit, partnerëve dhe klientëve tanë në vendin e punës dhe për të vlerësuar gjendjen tuaj në punë, për të siguruar akomodim të përshtatshëm në vendin e punës, për të monitoruar dhe menaxhuar mungesën dhe për të administruar përfitimet
- do të përdorim informacione në lidhje me racën tuaj, seksin ose çdo karakteristikë tjetër të mbrojtur për të ndihmuar me përpjekjet dhe nismat në lidhje me diversitetin dhe përfshirjen dhe monitorimin e rëndësishëm të mundësive të barabarta dhe raportimin
- do të përdorim anëtarësimin në këshillin e punës për të regjistruar statusin e mbrojtjes së posaçme kundër shkarkimit dhe për të përmbushur detyrimet ligjore të punësimit, kur është e zbatueshme
- do të përdorim anëtarësimin në sindikata për të paguar sigurimet e sindikatës, për të regjistruar statusin e një punonjësi të mbrojtur dhe për të respektuar detyrimet e ligjit të punësimit për të ngritur, ushtruar ose mbrojtur pretendimet ligjore, kur është e nevojshme

Nuk kemi nevojë për pëlqimin tuaj nëse përdorim kategori të veçanta të të dhënave tuaja personale në përputhje me politikën tonë të shkruar për të kryer detyrimet tona ligjore ose për të ushtruar të drejta specifike në fushën e ligjit të punësimit ose siç lejohet ndryshe nga ligjet e zbatueshme të mbrojtjes së të dhënave. Në rrethana të kufizuara, ne mund t'ju kontaktojmë për pëlqimin tuaj të shprehur me shkrim për të na lejuar të mbledhim dhe përpunojmë disa të dhëna personale veçanërisht delikate ose financiare. Nëse e bëjmë këtë, do t'ju japim detaje të plota për informacionin që do të donim dhe arsyen pse kemi nevojë për të, në mënyrë që të mund ta shqyrtoni me kujdes nëse dëshironi të jepni pëlqimin.

Informacion në lidhje me dënimet penale dhe listat e sanksioneve

Ju mund t'i nënshtroheni një shqyrtimi të listës globale të sanksioneve, ku ne (ose një nga ofruesit tanë të shërbimeve të palëve të treta) kërkojmë informacion rreth jush në burimet e

bazës së të dhënave që mbulojnë sanksionet, përputhshmërinë dhe zbatimin financiar, terrorizmin dhe korrupsionin, zbatimin e vendimeve penale dhe regjistrat e shkeljeve seksuale (në çdo kohë, në përputhje me ligjet në fuqi).

Ne do të mbledhim dhe përpunojmë informacion në lidhje me dënimet penale vetëm nëse është e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e rolit dhe ku ne jemi ligjërës në gjendje ta bëjmë këtë ose nëse keni pranuar në mënyrë të qartë të njëjtën gjë. I gjithë ky përpunim do të kryhet në përputhje me këtë Deklaratë Privatësie.

Përdorimi i të dhënave të punonjësve në sistemet gjeneruese AI për të mbështetur veprimtaritë e biznesit

Ne mund të përdorim sistemet e Inteligjencës Artificiale (AI) - duke përfshirë AI gjeneruese dhe mjetet e automatizuara të vendimeve - për një sërë qëllimesh biznesi, duke përfshirë por pa u kufizuar në mbështetjen e operacioneve të brendshme, rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit operacional, trajnimin dhe zhvillimin, monitorimin e sigurisë, kontrollin e cilësisë dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore ose rregullatore. Disa të dhëna të punonjësve, të tilla si të dhënat e gjeneruara, të ndara ose të ruajtura në sistemet e kompanisë - duke përfshirë komunikimet, dokumentet dhe përmbajtjet e tjera dixhitale - mund të aksesohen ose përpunohen nga këto sisteme AI.

Pajisjet personale dhe monitorimi

Siç përdoret këtu, "Burimet e PayPal-it" i referohet pajisjeve të zptëruara dhe të përdorura nga PayPal-i, softuerit, harduerit, medias së ruajtjes, sistemeve të informacionit, serverëve, rrjetit, sistemeve operative, objekteve dhe aplikacioneve të PayPal-it në pajisjet personale që ju regjistroni me ne.

Pajisje personale

Nëse zgjidhni të regjistroni pajisjen tuaj personale me PayPal-in, ne do të instalojmë softuerë kundër viruseve dhe për menaxhimin e pajisjeve celulare, për të monitoruar përdorimin e aplikacioneve të PayPal në pajisjen tuaj. Ky softuer do të ruajë të gjitha informacionet e lidhura me kompaninë, duke përfshirë kalendarët, email-et dhe aplikacionet e tjera në një fushë që është e mbrojtur me fjalëkalim dhe e sigurt. Ju mund të ruani informacionin në lidhje me PayPal-in vetëm në këtë zonë. Mund të mos përdorni aplikacione apo rezerva në renë kompjuterike që lejojnë transferimin e të dhënave në lidhje me kompaninë tek palë të treta të pasigurta. Në rast se humbni

pajisjen tuaj personale, ajo vidhet ose ne identifikojmë rreziqe në të që përbëjnë një kërcënim aktual ose potencial për PayPal-in, ne mund të zgjedhim të ndërpresim aksesin e pajisjes personale në aplikacione të tilla, ose të kryejmë një fshirje të pjesshme në distancë, gjë që na lejon të heqim vetëm aplikacionet që kanë akses në burimet e PayPal-it. Ne nuk mund të fshijmë të gjithë pajisjen tuaj personale.

Monitorimi i vendit të punës dhe burimeve të PayPal-it

Ne monitorojmë aktivitetet mbi burimet e PayPal-it në përputhje me ligjet e zbatueshme. Kjo përfshin, për shembull, skedarët, mesazhet, videon, audion, faqet e mediave sociale dhe postimet e aksesuara ose të shpërndara nëpërmjet një pajisjeje korporate ose aplikacioneve të menaxhuara në pajisje personale. Ne monitorojmë zyrat tona, dhe mjediset e tjera të punës, nëpërmjet monitorimit me video si televizioni me qark të mbyllur ("CCTV") dhe skanimet e

distinktivit për qëllime sigurie. CCTV përdoret kryesisht në hyrje dhe vendet ku mund të ketë pajisje me vlerë. CCTV nuk përdoret në hapësira private apo për të regjistruar rendimentin e punës. Rrjeti IT i PayPal-it monitorohet për të garantuar sigurinë e sistemeve të tij për ofrimin e shërbimeve të PayPal dhe për të mbrojtur klientët dhe punonjësit e tij. Ne gjithashtu mund të kryejmë monitorim për qëllime të tjera ligjore si p.sh. për të hetuar sjellje të pahijshme faktike ose të dyshuar, paligjshmëri ose shkelje të politikave dhe procedurave të PayPal për respektimin e detyrimeve ligjore (p.sh. për të siguruar që të drejtat tuaja statutores të punësimit janë përmbushur) ose për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale dhe pronës intelektuale. Ju mund të gjeni informacion në lidhje me aktivitetet tona të monitorimit në këtë Deklaratë Privatësie dhe politika apo njoftime të tjera të kompanisë që ne ju komunikojmë, si p.sh. përdorimi i lejueshëm i politikave të burimeve të kompanisë dhe udhëzimet e mediave sociale. Aty ku kërkohej me ligj, ne do të marrim pëlqimin tuaj për të monitoruar aktivitetet tuaja mbi burimet e PayPal në varësi të llojit të aktivitetit të monitorimit dhe arsyes për ta bërë këtë. Monitorimi do të bëhet në një mënyrë që është proporcionale dhe vetëm siç kërkohej ose lejohet nga ligji i zbatueshëm.

Duhet të jeni të vetëdijshëm se:

- informacioni i transmetuar ose i regjistruar në burimet tona të PayPal-it supozohet të jetë në lidhje me punën dhe ne ju rekomandojmë të mos përdorni burimet e PayPal-it për qëllime personale
- çdo informacion mund të monitorohet ose të aksesohet nga PayPal në përputhje me ligjet në fuqi dhe marrëveshjet e vendit të punës, si marrëveshjet e këshillit të punës, dhe si objekt i politikave të brendshme të PayPal-it në lidhje me aksesin dhe përdorimin e këtyre të dhënave

Çdo monitorim i kryer si i detajuar në këtë seksion mund të përdoret edhe në lidhje me veprimin disiplinor që ju përfshin, kur kërkohej, në përputhje me procedurën disiplinore vendore.

Shikoni Politikën e Përdorimit të Lejueshëm të Burimeve të Kompanisë për informacione të mëtejshme mbi përdorimin e lejuar të burimeve të PayPal-it dhe mënyrën se si mund t'i monitorojmë ato.

IV. Përse i ndajmë të dhënat personale

PayPal operon në nivel global, gjë që mund të na kërkojë të ndajmë të dhënat personale të listuara në seksionin II më sipër me partnerët e tjerë të PayPal-it, filialet, punonjësit, këshillet e punës, ofruesit e shërbimeve dhe palët e treta në shtete të tjera siç përshkruhet më poshtë, për qëllimet e përshkruara në këtë Deklaratë Privatësie. Ne i kërkojmë palëve të treta të respektojnë sigurinë e të dhënave tuaja dhe t'i trajtojnë ato në përputhje me ligjin e zbatueshëm. PayPal nuk i "shet" ose "ndan" të dhënat tuaja personale siç përcaktohet sipas ligjeve të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave. Për ata që janë banorë të Kinës, Japonisë dhe Koresë së Jugut, të dhënat tuaja personale mund të transferohen tek palët e treta të mëposhtme dhe palët e besuara që gjenden [këtu](#).

Ne mund të ndajmë të dhëna personale:

- për vënë në përdorim të dhënat e përshkruara në këtë Deklaratë Privatësie;
- me ofruesit tanë të shërbimeve që kryejnë shërbime për ne dhe funksione të tjera për ne dhe në emrin tonë. Marrësit e të dhënave si palë të treta përfshijnë ofruesit e

shërbimeve të investimeve financiare, ofruesit e sigurimeve, administratorët e pensioneve dhe ofruesit e tjerë të përfitimeve, ofruesit e kujdesit për fëmijët, shërbimet e mbështetjes së pagave, ofruesit e mbështetjes financiare dhe të kontabilitetit, kompanitë e kontrollit të figurës, shërbimet e zhvendosjes, të menaxhimit të tatimeve dhe udhëtimit, ekspertët e shëndetit dhe sigurisë, menaxhimin e strukturave, ofruesit e shërbimeve IT, dhe shërbimet e sigurisë;

- për të respektuar detyrimet, rregulloret apo kontratat tona ligjore ose për t'ju përgjigjur kërkesave të ligjshme të autoriteteve publike (p.sh., zbatimit të ligjit), urdhrave të gjykatës, auditimeve qeveritare, fletë-thirrjeve dhe urdhër-arresteve;
- kur kërkojmë këshilla ligjore nga avokatët tanë dhe këshilltarët e tjerë profesionistë;
- për të ushtruar ose ofruar mbrojtje kundër një kërkesë ligjore të mundshme ose faktike;
- sipas nevojës për të mbrojtur interesat tona, interesat tuaja themelore dhe ato të individëve të tjerë, si p.sh., parandalimi i humbjes financiare, garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë;
- në lidhje me një shitje, shitje të një pjese të aseteve ose transferim të të gjithë ose një pjese të biznesit tonë (si për shembull të blerësi potencial dhe këshilltarët e tij profesionistë); dhe në një formë tjetër, në përputhje me pëlqimin tuaj.

V. Si dhe ku i transferojmë dhe ruajmë të dhënat tuaja personale

PayPal-i transferon të dhënat personale në rrjedhën normale të biznesit dhe të dhëna të tilla personale mund të transferohen jashtë shtetit ku janë mbledhur fillimisht për qëllime të përshkruara në këtë Deklaratë Privatësie ose, sipas rastit, ndonjë njoftim apo dokument specifik lidhur me mbrojtjen e të dhënave në juridiksionin tuaj. Megjithatë kemi selinë në Shtetet e Bashkuara, informacioni i mbledhur në shtete të tjera transferohet vazhdimisht në Shtetet e Bashkuara për përpunim në masën e nevojshme dhe siç lejohet për përdorimet e përshkruara në këtë Deklaratë Privatësie. Ne kemi ndërmarrë hapa të veçantë, në përputhje me ligjin e në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në lidhje me transferime të tilla dhe do të zbatojmë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse të miratuara nga rregullatori kompetent herë pas here. Në veçanti, ne mbështetemi në Rregullat Detyruese Korporative të miratuara nga autoritetet kompetente mbikëqyrëse (të [disponueshme këtu](#)). Për transferimet e të dhënave personale të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Emirateve të Bashkuara Arabe te palët e treta që ndodhen jashtë BE-së, Zonës Ekonomike Evropiane, Mbretërisë së Bashkuar ose Emirateve të Bashkuara Arabe, ne mbështetemi në Klauzolat Standarde Kontraktuale, një kopje të të cilave mund ta kërkonit nga Oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave të PayPal-it duke përdorur të dhënat e mëposhtme të kontaktit. Ne do t'ju japim informacion më të detajuar në lidhje me shtetet në të cilat transferohen të dhënat tuaja personale sipas kërkesës.

VI. Si e mbrojmë informacionin tuaj?

PayPal-i është e angazhuar për të mbrojtur sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave tuaja personale. Ne e bëjmë këtë duke zbatuar kontrollet e nevojshme që ndryshojnë në varësi të ndryshimisë së të dhënave personale që ne përpunojmë. Kontrolle të tilla përfshijnë enkriptimin, kufizimet e aksesit dhe masa të tjera teknike dhe organizative për të siguruar mbrojtjen e të dhënave tuaja personale dhe për të parandaluar që këto të dhëna të humbin, përdoren ose aksesohen aksidentalisht në mënyrë të paautorizuar. Përveç kësaj, ne kufizojmë

aksesin në të dhënat tuaja personale për ata punonjës, agjentë, kontraktorë, nën-përpunues dhe palë të tjera të treta që kanë nevojë të dinë lidhur biznesin. Në rast se ne ose një nga ofruesit tanë të shërbimit jemi të përfshirë në një shkellje të dyshuar të sigurisë së të dhënave, do t'ju informojmë ju dhe çdo rregullator të vlefshëm nëse na kërkohet ligjërisht ta bëjmë këtë.

VII. Sa kohë i mbajmë të dhënat tuaja personale?

Ne i ruajmë të dhënat tuaja personale për aq kohë sa nevojitet në mënyrë të arsyeshme për të përmbushur qëllimet për të cilat i kemi mbledhur, duke përfshirë për qëllime të përmbushjes së çdo kërkesë ligjore, të burimeve njerëzore, rregullatore, tatimore, llogaridhënës ose raportuese, ose për aq kohë sa deklarata juaj e pëlqimit (sipas rastit) na lejon t'i mbajmë ato, dhe në çdo rast për aq kohë sa vazhdon marrëdhënia e punësimit. Pasi marrëdhënia e punësimit ose angazhimi të ketë përfunduar, të dhënat do të mbahen, të siguruara siç duhet, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore ose kontraktuale sipas rastit dhe për kohën e nevojshme për një përputhje të tillë. Ne mund të mbajmë të dhënat tuaja personale në rast të një ankese ose nëse besojmë në mënyrë të arsyeshme se ka një perspektivë për proces gjyqësor në lidhje me marrëdhënien tonë me ju. Politika jonë e ruajtjes së të dhënave përshkruan afate të ndryshme të ruajtjes në bazë të llojit ose kategorisë së të dhënave personale të përpunuara. Referojuni politikës së ruajtjes së të dhënave për më shumë informacion. Ne do të shkatërrojmë të dhënat tuaja personale në një mënyrë që nuk na lejon të rikuperojmë informacionin dhe/ose do të ndërmarrim hapa për t'i anonimizuar siç duhet në mënyrë që ju të mos identifikoheni më prej tyre.

VIII. Të drejtat tuaja të privatësisë

Është e rëndësishme që të dhënat personale që mbajmë për ju të jenë të sakta dhe aktuale. Na mbani të informuar nëse ndonjë nga të dhënat tuaja personale ndryshon gjatë marrëdhënies suaj të punës me ne.

Punonjësit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të PayPal-it dhe agjentët e tyre të autorizuar mund të bëjnë kërkesa të caktuara aty ku lejohet, në lidhje me të dhënat e tyre personale, të cilat mund të jenë të ndryshme në varësi të ligjeve në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Në varësi të juridiksionit në vendin ku banoni dhe në respektim të përjashtimeve në fuqi dhe ndryshimeve përcaktuese midis shteteve të ndryshme të SHBA-së dhe ligjeve të tjera për mbrojtjen e të dhënave, mund të keni të drejtë të:

- kërkonte akses (të drejtën për të njohur informacionin tuaj) dhe merrni një kopje të të dhënave tuaja personale që kemi për ju.
- njihni palët e treta të cilave u kemi bërë të ditura të dhënat personale.
- kërkonte korrigjimin e të dhënave tuaja personale.
- kërkonte fshirjen e të dhënave tuaja personale.
 - o Gjatë përpunimit të kërkesave tuaja për fshirje, ne vlerësojmë kërkesën kundrejt politikave tona të korporatës, nëse qëllimet për të cilat informacioni i mbledhur fillimisht janë përmbushur dhe të dhënat nuk kërkohen më. Për shembull, në masën e lejuar nga ligji në fuqi, ne mund të refuzojmë një kërkesë fshirje brenda interesave tona të ligjshme, nëse ruajtja e të dhënave tuaja personale është e nevojshme, për të përmbushur kërkesat ligjore, ose për të ndihmuar në menaxhimin e rreziqeve dhe sigurisë së personelit të PayPal.
- kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale.
- kërkonte transportimin e të dhënave tuaja personale në një kompani tjetër.

- paraqisni një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës dhe të kërkonti një ndreqje gjyqësore, kur është e lejuar.

Për më tepër, ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale.

Disa ligje shtetërore në SHBA u ofrojnë gjithashtu banorëve të atyre shteteve të drejtën për të hequr dorë nga

"shitja" (zbulimi i informacioneve personale në këmbim të parave ose kompsimeve të tjera) ose "ndarja" (zbulimi i informacioneve personale për reklamat ndër-kontekstuale të sjelljes) e informacionit tuaj personal ose përdorimi i informacionit tuaj personal për disa lloje të reklamave të synuara. PayPal-i nuk i shet ose ndan të dhënat tuaja.

Në rast se ne përpunojmë të dhënat personale duke u mbështetur në pëlqimin tuaj, ju keni të drejtë ta tërhiqni atë në çdo kohë. Vini re megjithatë se kjo nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit përpara tërheqjes së tij.

Ne do t'i përgjigjemi çdo kërkesë të bërë nga ju ose një agent i autorizuar, sipas rastit, në përputhje me ligjin në fuqi, dhe mund të ketë rrethana kur ne nuk mund të plotësojmë kërkesën tuaj. Referojuni seksionit "Na kontaktoni" më poshtë për mënyrën se si të kontaktoni me ne për të ushtruar të drejtat tuaja të privatësisë ose për të bërë një ankesë.

Vini re se jo të gjitha këto të drejta do të zbatohen gjatë gjithë kohës. Nëse kualifikoheni për të drejta të tjera, nëse keni ose jo një të drejtë specifike dhe do të aplikohet nëse një e drejtë specifike që keni, do të varet nga rrethanat, siç është juridiksioni juaj. Na dërgoni email në globalprivacy@paypal.com për më shumë informacion.

IX. Ndryshimet në këtë deklaratë

Herë pas here, ne do të bëjmë ndryshime në këtë Deklaratë Privatësie për t'u siguruar që jemi të përditësuar me ndryshimet në praktikat dhe ligjet tona, dhe do t'ju japim një njoftim prej 21 ditësh për çdo ndryshim material dhe, nëse kërkohet nga ligji në fuqi, do të kërkojmë pëlqimin tuaj përpara se këto ndryshime të hyjnë në fuqi. Ne gjithashtu mund t'ju njoftojmë në mënyra të tjera herë pas here për përpunimin e të dhënave tuaja personale. Ju rekomandojmë të shqyrtoni këtë Deklaratë Privatësie në mënyrë periodike për të kuptuar praktikatat e privatësisë së PayPal dhe të drejtat që mund të keni.

X. Gjuha

Kjo Deklaratë Privatësie është shkruar në disa gjuhë ku origjinalja është versioni në anglisht. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ose mospajtimi midis versionit origjinal në anglisht dhe çdo përkthimi në ndonjë gjuhë tjetër, do të mbizotërojë versioni i gjuhës lokale.

XI. Na kontaktoni

Kontrolluesi i të dhënave, përgjegjës për të dhënat tuaja personale është subjekti PayPal që ju ka punësuar. Nëse dëshironi të mësoni më shumë se si PayPal i përpunon të dhënat personale, të ushtroni të drejtat tuaja të privatësisë ose të bëni një ankesë apo nëse keni pyetje rreth kësaj Deklarate Privatësie, bëni një kërkesë zyrtare pranë Zyrës Qëndrore të Punonjësve në

Departamentin e Burimeve Njerëzore në Bridge, telefononi në numrin +1-855-489-0343, x 6, dërgoni email tek Global Privacy Team në adresën globalprivacy@paypal.com ose kontaktoni Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave të PayPal, Gareth Jones, në PayPal (Europe) S.à.r.l. et Cie, S.C.A., 22-24 Boulevard Royal L-2449, Luksemburg.